

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children



PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE: “PLANI I VEPRIMIT TË PROMOCIONIT SHËNDETËSOR, SHQIPËRI 2022-2030”



Shkurt 2022

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	3
PROMOCIONI SHËNDETËSOR: KONTEKSTI DHE SITUATA NË SHQIPËRI.....	5
Çfarë është promocioni shëndetësor?	5
Argumentimi dhe qëllimi i Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor	5
Analiza e Situatës	5
Shembull: Obeziteti, një nga sfidat më të mëdha	7
COVID-19 – një kujtesë për të zgjeruar promocionin shëndetësor	7
Vdekshmëria neonatale dhe amtare	7
Faktorër kryesorë të rrezikut për sëmundshmëri dhe vdekshmëri në popullatën shqiptare	7
Vlerësimi i Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor, Shqipëri 2017-2021	8
VIZIONI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË PLANIT TË RI TË VEPRIMIT TË PROMOCIONIT SHËNDETËSOR, SHQIPËRI 2022-2030	8
Vizioni	8
Qëllimi	9
Objektivat Strategjike	9
MONITORIMI DHE VLERËSIMI	12
ANEKS. OBJEKTIVAT SPECIFIKE, INDIKATORËT DHE AKTIVITETET	13
Objektivi Strategjik 1	13
Objektivi Strategjik 2	18
Objektivi Strategjik 3	21
Objektivi Strategjik 4	23

PËRMBLEDHJE

Kjo përmbledhje e politikave është një përmbledhje e “Planit të Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030”, i cili është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe mbështetet nga një gamë e gjerë aktorësh dhe faktorësh kryesorë në nivel kombëtar dhe lokal.

Kjo përmbledhje u drejtohet kryesisht politikëbërësve dhe vendimmarrësve, por edhe të gjithë profesionistëve, ekspertëve dhe individëve të përfshirë në edukimin shëndetësor dhe promovimin e shëndetit, duke përfshirë profesionistët shëndetësorë, edukatorët shëndetësorë, specialistët e promocionit shëndetësor, menaxherët shëndetësorë dhe administratorët e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, si dhe mbarë popullsia shqiptare.

Kjo përmbledhje politikash është ndërtuar rreth parimeve të 'vlerësimit', 'shpjegimit' dhe 'veprimit' mbi problemet më të spikatura shëndetësore në Shqipëri, të fokusuara në të gjitha sëmundjet, por kryesisht në sëmundjet jo të transmetueshme (SJT), përveç kancerit i cili ka një plan të veçantë veprimi. Fokusi është tek SJT-të, pasi këto sëmundje përbëjnë 93% të vdekshmërisë totale dhe më shumë se 80% të barrës së përgjithshme të sëmundshmërisë në popullatën shqiptare. Me një diferencë të gjerë, 'vrasësit' më të spikatur nga SJT-të janë sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut (të quajtura edhe sëmundjet 'kardiovaskulare').

“Plani i ri i Veprimit për Promocionin Shëndetësor 2022-2030” fokusohet në përmbajtje promociionale dhe, përveç SJT-ve, përmban elemente për parandalimin e kërcënimeve të reja nga sëmundjet infektive (p.sh. COVID-19).

Struktura e përgjithshme e këtij raporti politikash është e ngjashme me planin e plotë të veprimit të promocionit shëndetësor. Prandaj, lexuesit e interesuar duhet t'i referohen dokumentit të plotë “Plani i Veprimit të Promocionit Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030”.

‘Vlerëso’, ‘Shpjego’ dhe ‘Vepro’

VLERËSIMI

“Vrasësit” kryesorë në Shqipëri, sikurse në shumicën e vendeve të zhvilluara, janë:

- Presioni i lartë i gjakut
- Duhanpirja
- Mbipesha dhe obeziteti
- Niveli i lartë i kolesterolit në gjak
- Diabeti (niveli i lartë i sheqerit në gjak)
- Ushqyerja e pashëndetshme

Këto faktorë risku janë shkaqet kryesore që çojnë në aterosklerozë, d.m.th. ngurtësim dhe inflamacion të arterieve; kur arteriet bllokohen, indet e poshtme vdesin. Në varësi të territorit të furnizuar me gjak nga arteriet, ky

proces çon në atak kardiak, insult cerebral, si dhe në shumë sëmundje të tjera.

- Konusmi i alkoolit.

SHPJEGIMI

Baza shkencore për faktorët e lartpërmendur duhet të shpjegohet, kryesisht me fokus në popullatën shqiptare dhe rrezikun që këto faktorë përfaqësojnë në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).

VEPRIMI

Plani i Veprimit të Promocionit Shëndetësor propozon një gamë të gjerë ndërhyrjesh për përmirësimin e situatës në popullatën shqiptare përfshi ndërhyrjet në shkolla dhe në vendet e punës, përmes rrjeteve sociale dhe mediave tradicionale, etj.

Konsiderata të rëndësishme

Në tërësi, është e rëndësishme që të kuptohen çështjet e mëposhtme:

- Rritja e SJT-ve në Shqipëri është në një farë mënyre indirekte një shenjë e suksesit të politikave të mëparshme afatgjatë shëndetësore, pasi sëmundjet infektive janë reduktuar jashtëzakonisht dhe jetëgjatësia mesatare në Shqipëri po rritet;
- Është urgjente të veprohet tani për të reduktuar dëmin në rritje të shpejtë;
- Lufta kundër sëmundjeve kardiovaskulare kërkon mbështetje afatgjatë politike, financiare dhe popullore;
- Grupet vulnerabël dhe pakicat e marginalizuara kanë nevojë për masa të veçanta mbështetëse.

Specifiteti

E rëndësishme është se “Plani i ri i Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030” përcakton katër objektiva strategjikë, secili me një sërë synimesh specifike, aktivitete të nevojshme për të arritur këto objektiva, si dhe tregues konkretë të suksesit.

Në përgjithësi, “Plani i Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030” është i përshtatshëm për të shërbyer si një udhërrëfyes për vendime të gjera dhe të detajuara politikash.

Ky plan veprimi dallohet nga dokumenti tjetër i politikave “Plani i Veprimit për SJT-të, Shqipëri 2021-2030” në atë që fokusohet më shumë në promovimin e shëndetit në popullatë, ndërsa plani i veprimit për SJT-të përfshin, përveç promovimit të shëndetit, strategji më të gjera politikash, siç janë çështjet e financimit, politikave tatimore dhe ndërhyrje tjera të ngjashme.

PROMOCIONI SHËNDETËSOR: KONTEKSTI DHE SITUATA NË SHQIPËRI

Çfarë është promovimi shëndetësor?

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, promovimi shëndetësor është procesi i aftësimit të njerëzve për të rritur kontrollin dhe për të përmirësuar shëndetin e tyre. Ai shkon përtej fokusit në sjelljen individuale drejt një game të gjerë ndërhyrjesh sociale dhe mjedisore¹.

Megjithatë, ekziston një shans: shumica e problemeve shëndetësore dhe vdekjeve të parakohshme shkaktohen nga sjelljet njerëzore dhe për këtë arsye janë të parandalueshme nëpërmjet ndryshimeve të sjelljes. Ky është arsyetimi kryesor për programet shëndetësore siç është edhe ky dokument.

Argumentimi dhe qëllimi i Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor

Në të gjitha sferat e jetës, si politika, familja, biznesi etj., është e njohur që vetëm informacioni nuk është pothuajse i mjaftueshëm për të përmirësuar një problem. Po kështu, përmirësimi i shëndetit kërkon jo vetëm informacion, por varet nga një grup kompleks ndërhyrjesh për të ndryshuar sjelljet. Tashmë ka evidencë dhe prova të gjera shkencore për ndërhyrje që mund të ndryshojnë sjelljet².

Gjithashtu, përdorimi efikas dhe efektiv i parasë publike është një kriter kyç për ndërhyrjet shëndetësore. Është gjithashtu një përgjegjësi publike të sigurohet se paratë private të konsumatorëve po shpenzohen për masa me vlerë të provuar.

Si pasojë, ndërhyrjet për përmirësimin e shëndetit kanë nevojë për rishikim të kujdesshëm të të dhënave shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, planifikim të mëtijshëm dhe reagime të përhershme. Ndërhyrjet shëndetësore duhet të fokusohen në parandalimin, jo vetëm në përmirësimin e trajtimit. Ky është qëllimi i aksionit për promovimin e shëndetit; një plan i tillë është kyç për çdo politikë shëndetësore në të gjitha vendet, përfshirë Shqipërinë.

Plani aktual i Veprimit për Promocionit Shëndetësor për Shqipërinë fokusohet në përmbajtje promovuese dhe, përveç sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT), përmban elemente për parandalimin e kërcënimeve të reja nga sëmundjet infektive (p.sh. COVID-19). Në të kundërt, Plani i Veprimit për SJT-të për Shqipërinë fokusohet në parandalimin e SJT-ve pa detajuar përmbajtjen promovuese.

Analiza e Situatës

Të dhëna të detajuara gjenden në dokumentin e plotë: “Plani i Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030”, por, në thelb, baza e politikave aktuale shëndetësore

¹ World Health Organization. Health Promotion. <https://www.who.int/teams/health-promotion/enhanced-wellbeing/first-global-conference#:~:text=Health%20promotion%20is%20the%20process,or%20cope%20with%20the%20environment.>

² Michie S, et al. The behavior change wheel: A new method for characterizing and designing behavior change interventions. Implementation Science 2021; 6 (42). [https://implementationscience.biomedcentral.com/articles/10.1186/1748-5908-6-42.](https://implementationscience.biomedcentral.com/articles/10.1186/1748-5908-6-42)

është një sukses kombëtar. Nga viti 1990 deri në vitin 2030, jetëgjatësia mesatare në Shqipëri është rritur nga rreth 70 vjet në 78 vjet³.

Vdekshmëria neonatale është ulur me 52% midis 2009 dhe 2019, duke kontribuar kështu në rritjen e jetëgjatësisë, së bashku me institucionet më të mira për trajtimin e sëmundjeve. Gjithashtu, shkalla e fertilitetit është ulur, duke rritur më tej jetëgjatësinë mesatare në Shqipëri⁴. Efektiviteti i trajtimit të sëmundjeve është përmirësuar gjithashtu.

Rënia e normave të vdekshmërisë së standardizuar sipas moshës dhe barrës së sëmundjeve nga SJT-të në popullatën shqiptare është më e dukshme se në shumicën e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor⁵.

Këto zhvillime kanë patur tre pasoja:

1. Vdekshmëria '*sipas grup-moshave*' është ulur. Kjo quhet 'nivel i standardizuar i vdekshmërisë'. Niveli i standardizuar i vdekshmërisë nga SJT-të ka rënë nga një vlerë prej 673 në vitin 1990 në një vlerë prej 520 (vdekje për 100,000 banorë) në vitin 2019. Vdekshmëria e përgjithshme është rritur nga 528 në 833 për 100,000 banorë (niveli i vdekshmërisë rritet me moshimin e popullatës) [INSTAT, 2021].
2. Natyra e sëmundjeve ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Sëmundjet infektive (d.m.th. të transmetueshme) kanë rënë dhe SJT-të janë rritur në mënyrë dramatike, megjithëse kriza e COVID-19 e ka përmbysur këtë prirje në një farë mase.
3. E rëndësishme, sëmundja nuk është vetëm një problem i jetës ose i vdekjes. Shpesh çon në paaftësi. Prandaj, është zhvilluar një metodë statistikore e quajtur 'vitet e jetës të përshtatura me aftësinë e kufizuar' (DALY). Ai pasqyron idenë se çdo reduktim në një jetë të shëndetshme është një humbje në një masë më të madhe ose më të vogël. Kështu, llogaritjet e DALY-ve kombinojnë vitet e humbura për shkak të paaftësisë ose vdekjes së parakohshme. Aftësitë e kufizuara mund të jenë pak a shumë të rënda; një shembull është goditja në tru, e cila mund të çojë në paralizë të plotë të njërës anë të trupit ose vetëm në dobësi të vogël. Prandaj, metoda DALY prezanton korrigjime për këto dallime. Detajet e përlllogaritjeve të ndërlikuara gjenden në: www.who.int, por në thelb në Shqipëri, në vitin 2019 DALY-t për shkak të SJT-ve ishin 17,621. Kjo do të thotë se 17,621 vite jetë të shëndetshme humbën për çdo 100,000 persona (korrigjuar sipas moshës). Edhe pse, për fat, kjo shifër ka rënë nga 21,036 në vitin 1990, ajo është ende mjaft e lartë në krahasim me shumë vende të Bashkimit Evropian. Vlen të përmendet se krahasimet me vendet e tjera nuk do të thotë se shifrat e tyre janë ideale; qëllimi përfundimtar i së ardhmes në mbarë botën është që DALY-të t'i afrohen

³ Institute of Statistics (INSTAT). <http://www.instat.gov.al/>.

⁴ Gjonca A, et al. Demographic and Health Challenges Facing Albania in the 21st Century. https://albania.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/albania_demographic_health_challenges_report_2020_english_version.pdf.

⁵ <http://ghdx.healthdata.org/gbd-results-tool>.

pothuajse zeros, pra një jetë pothuajse e shëndetshme deri në (një kohë të shkurtër para) vdekjes.

Shkaktarët kryesorë të vdekshmërisë në Shqipëri përbëhen nga sëmundjet ishemike të zemrës, të ndjekura nga goditjet në tru, kanceri i mushkërive, sëmundja e Alzheimerit dhe sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK).

Me pak modifikime, këto gjendje janë edhe shkaktarët kryesorë të barrës së sëmundshmërisë (të shprehura në DALY) në popullatën shqiptare.

Shembull: Obeziteti, një nga sfidat më të mëdha

Të dhënat aktuale tregojnë një ndryshim të rëndësishëm në madhësinë dhe shpërndarjen e faktorëve të rrezikut në popullatën shqiptare. Obeziteti shquhet me një rritje të trefishtë në një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Kjo rritje e madhe vihet re tek fëmijët e vegjël në Shqipëri, por më së shumti tek meshkujt e rritur (nga 15 deri në 60 vjeç), ku mbi 66% janë mbipeshë. Obeziteti lidhet me hipertensionin dhe diabetin si dhe me kolesterolin e lartë në gjak; prandaj, rritja e tij sjell ndryshime katastrofike në të ardhmen.

COVID-19 – një kujtesë për të zgjeruar promocionin shëndetësor

Informacioni zyrtar më i fundit nga Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) tregon se jetëgjatësia e përgjithshme në Shqipëri në vitin 2020 ishte 75.2 vjet për burrat dhe 79.6 vjet për gratë, një rënie nga shifrat e vitit 2019 (77.6 vjet për meshkujt dhe 80.6 vjet tek femrat, INSTAT, 2020). Sipas të gjitha gjasave, vdekjet e tepërta (shtesë) për shkak të COVID-19 shpjegojnë këtë rënie të jetëgjatësisë.

Së bashku me pasojat e njohura psikologjike, edukative dhe ekonomike të COVID-19, këto shifra janë një kujtesë e fortë se promovimi i shëndetit në të ardhmen duhet të përqendrohet jo vetëm tek SJT-të, por edhe në sëmundjet infektive, njësoj si në të kaluarën, por me shfaqjen e entiteteve të reja sëmundjeve infektive.

Vdekshmëria neonatale dhe amtare

Sukseset në uljen e vdekshmërisë neonatale dhe amtare në Shqipëri nuk duhet të errësojnë faktin se të dyja janë ende më të larta se në shumicën e vendeve evropiane, duke ilustruar kështu nevojën për të forcuar promovimin e shëndetit tek femrat në moshë riprodhuese, partnerët e tyre dhe familjet.

Faktorët kryesorë të rrezikut për sëmundshmëri dhe vdekshmëri në popullatën shqiptare

Barra e sëmundjeve në popullatën shqiptare shkaktohet nga një gamë e gjerë përcaktuesish që i përkasin rreziqeve metabolike, rreziqeve mjedisore/profesionale dhe rreziqeve të sjelljes. Faktorët kryesorë të rrezikut të vdekshmërisë dhe barrës së sëmundjeve (vdekshmëria dhe sëmundshmëria së bashku) në popullatën shqiptare, bazuar në informacionin më të fundit të

disponueshëm nga IHME (GBD, 2020) përfshijnë presionin e lartë të gjakut (faktori kryesor i rrezikut), duhanin dhe faktorët e ushqyerjes⁶.

Në thelb, të dhënat aktuale tregojnë një ndryshim të rëndësishëm në madhësinë dhe shpërndarjen e faktorëve të rrezikut në popullatën shqiptare, veçanërisht me një rritje të trefishtë të obezitetit. Hipertensioni është në rritje edhe në popullatën e përgjithshme të Shqipërisë, duke paraqitur një kërcënim serioz, veçanërisht për rritjen e shkallës së vdekshmërisë nga sëmundjet kardiovaskulare. Gjithashtu, barra e sëmundshmërisë që i atribuohet duhanit (faktori i dytë kryesor i rrezikut) përbën 15% të barrës së përgjithshme të sëmundjeve në popullatën shqiptare (GBD, 2020).

Vlerësimi i Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor, Shqipëri 2017-2021

Hapi fillestar në zhvillimin e “Planit të Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030” konsistonte në një rishikim të planit të mëparshëm të veprimit nëpërmjet një rishikimi të detajuar, si dhe intervistave të aktorëve kryesorë.

Konsensusi ishte se është arritur shumë përparim, por shumë aktivitete të parashikuara në “Planin e Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2017-2021” janë zbatuar vetëm pjesërisht, me pengesa të paparashikuara si tërmeti i Nëntorit 2019 dhe kriza e COVID-19 që nga fillimi i vitit 2020. Faktorë të tjerë përfshijnë mungesën e financimit të duhur, burimet njerëzore të pamjaftueshme, infrastrukturën e dobët, ndryshimet e fundit organizative (krijimi i operatorëve shëndetësorë), si dhe planifikimi i dobët i disa ndërhyrjeve për promovimin e shëndetit.

Vlen të përmendet se ishte e vështirë të vlerësohej shkalla e zbatimit të disa ndërhyrjeve për shkak të mungesës së treguesve të mirëpërcaktuar dhe të matshëm.

VIZIONI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË PLANIT TË RI TË VEPRIMIT TË PROMOCIONIT SHËNDETËSOR, SHQIPËRI 2022-2030

Plani i ri i Veprimit për Promocionin Shëndetësor synon rinovimin e promovimit shëndetësor nëpërmjet veprimeve sociale, politike dhe teknike, duke adresuar sfidat shëndetësore, me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe uljen e pabarazive shëndetësore të popullsisë shqiptare. Ky plan veprimi është vendosur në kuadër të Axhendës 2030, në përputhje me dokumente të tilla si Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë në Shqipëri 2021-2030; Plani i Veprimit për SJT-të 2021-2030; Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2022-2030, etj.

Vizioni

Jetë e shëndetshme dhe mirëqenie për të gjithë popullatën shqiptare.

⁶ <http://ghdx.healthdata.org/gbd-results-tool>.

Qëllimi

Qëllimi i Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor në Shqipëri 2022-2030 është të sigurojë mbrojtje dhe promovim të shëndetit dhe mirëqenies së popullatës shqiptare përmes fuqizimit dhe përfshirjes së individëve, familjeve dhe komuniteteve në partneritet me ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe të gjithë aktorët e tjerë.

Objektivat Strategjike

Plani i ri është i ndarë në katër objektiva strategjikë, secili me një sërë objektivash specifike që lejojnë monitorimin përmes treguesve si parakusht për ndryshimet e ardhshme.

Vlen të përmendet se ekziston një listë e plotë e objektivave specifike në Aneksin e këtij dokumenti, së bashku me një listë treguesish dhe aktiviteteve. Kjo për faktin se çdo lexues mund të ketë interesa të ndryshme në lidhje me objektivat (p.sh. mësuesit për objektivat e shkollës, personeli shëndetësor për kontrollat mjekësore, etj.).

Më poshtë jepen vetëm disa shembuj të spikatur të objektivave specifike dhe treguesve dhe aktiviteteve të lidhura me to për të treguar përmirësimin e madh në krahasim me planin e mëparshëm të veprimit.

Objektivi strategjik 1: Rritja e vetëdijes së popullatës shqiptare për shëndetin dhe orientimi drejt një mënyre jetese të shëndetshme si dhe aksesit dhe përdorimit të duhur të shërbimeve shëndetësore.

Objektivi specifik 1.1: Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës.

Indikatorët (shembuj):

- Përdorimi i shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë nga të paktën 70% e popullatës target (individët 35-70 vjeç).
- Të paktën 80% e popullatës target përdor në mënyrën e duhur shërbimet e monitorimit të shtatzënisë dhe mirërritjes së fëmijës.

Aktivitetet (shembuj):

1. Organizimi i fushatave sensibilizuese për rëndësinë e kontrollit mjekësor falas.
2. Organizimi i fushatave sensibilizuese për rëndësinë e monitorimit të shtatzënisë dhe më pas zhvillimit dhe mirërritjes së foshnjave.

Objektivi specifik 1.2: Promovimi i një stili jete të shëndetshme për të gjithë popullatën shqiptare për të siguruar fëmijë, adultë dhe të moshuar më të shëndetshëm.

Indikatorët (shembuj):

- 60% e të rinjve në shkolla kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me ushqyerjen e shëndetshme.

- Rritja me 20% e ushqyerjes me gji e fëmijëve 0-2 vjeç.

Aktivitetet (shembuj):

1. Mbështetja e nismave që rrisin disponueshmërinë, aksesueshmërinë dhe përballueshmërinë e ushqimit të shëndetshëm, veçanërisht në mesin e grupeve më vulnerabël.
2. Zhvillimi i programeve që rrisin njohuritë mbi ushqimet dhe ushqyerjen dhe aftësitë e prindërve, fëmijëve dhe grupeve të tjera më vulnerabël nga ushqimi i varfër.
3. Monitorimi i obezitetit çdo 3 vjet te fëmijët e moshës 6-9.9 vjeç si pjesë e Studimit Europian të Mbikëqyrjes së Obezitetit në Fëmijëri (COSI).
4. Kryerja çdo 4 vjet e studimit mbi sjelljet shëndetësore të fëmijëve 11, 13 dhe 15 vjeç (HBSC).

Objektivi specifik 1.3: Reduktimi i sjelljeve të rrezikshme në mesin e popullatës shqiptare (pirja e duhanit, përdorimi i dëmshëm i alkoolit dhe drogave të paligjshme).

Indikatorët (shembuj):

- 85% e fëmijëve dhe e të rinjve të moshës shkollore kanë njohuri të mjaftueshme mbi rreziqet e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave.
- Ulja me 10% e duhanpirësve aktual në popullatën 15-64 vjeç.
- Ulja me 30% e përdorimit të kanabisit në popullatën 15-64 vjeç.

Aktivitetet (shembuj):

1. Organizimi i fushatave kombëtare për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme në mesin e popullatës shqiptare, të fokusuara në pirjen e duhanit, përdorimin e dëmshëm të alkoolit dhe drogat e paligjshme: "Dita Botërore Pa Duhan"; "Fushata Botërore e Drogës".
2. Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e ligjit anitduhan, ligjit kundër konsumimit të alkoolit nga të miturit dhe ligjit kundër përdorimit të drogës.
3. Kryerja e studimit mbi vlerësimin e duhanpirjes tek të rinjtë në shkolla, në kuadër të "Iniciativës Globale të Studimit mbi Duhanpirjen" (GYTS).

Objektivi strategjik 2: *Fuqizimi i mjediseve mbështetëse dhe nxitja e ndërhyrjeve efikase për zbatimin e programeve të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor.*

Objektivi specifik 2.2: Rritja e aksesit të popullatës në shkollat promovuese të shëndetit me qasjet e DSSH.

Indikatorët (shembull):

- Numri i rretheve që po zbatojnë politika ose strategji të bazuara në udhëzimet kombëtare për shkollat e shëndetshme.

Aktivitetet (shembuj):

1. Zgjerimi i rrjeteve shkollore që promovojnë shëndet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar Planifikim dhe bashkim me rrjetin e shkollave që promovojnë shëndet (Shkollat për Shëndetin në Evropë, SHE).
2. Zhvillimi, miratimi dhe zbatimi i politikave për shkollat promovuese të shëndetit.

Objektivi specifik 2.4: Rritja e përdorimit të teknologjisë, veçanërisht e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e mjediseve që promovojnë shëndetin.

Objektivi specifik 2.5: Rritja e efektivitetit në punë e profesionistëve të rrjetit të edukimit dhe promocionit shëndetësor.

Objektivi specifik 2.6: Forcimi i sistemeve për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për të përmirësuar dokumentimin dhe shkëmbimin e praktikave, mësimave të nxjerra dhe rezultateve që lidhen me nisma të bazuara në mjedise, me fokus barazinë e individëve.

Objektivi strategjik 3: *Përmirësimi i qeverisjes dhe punës ndër-sektoriale për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien dhe adresimin e përcaktorëve socialë të shëndetit.*

Indikatorët (shembull):

- Buxheti për promocionin shëndetësor të rritet me 5% çdo vit.

Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi dhe/ose forcimi i strukturave dhe nismave të qeverisjes vendore për të përfshirë promocionin shëndetësor si një prioritet.

Indikatorët (shembuj):

- Krijimi i një rrjeti të Qyteteve të Shëndetshme duke përfshirë të paktën katër bashki.

Aktivitetet (shembuj):

1. Krijimi i një rrjeti kombëtar për Qytetet e Shëndetshme dhe bashkëpunimi me shoqatat rajonale dhe kombëtare të qyteteve dhe bashkive për të siguruar që shëndeti të përfshihet në axhendat e tyre.

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i bashkëpunimit të sektorit shëndetësor me sektorët e tjerë publik që adresojnë DSSH në nivele të ndryshme qeveritare

Indikatorët (shembull):

- Ngritja e një komiteti ndërsektorial për promocionin shëndetësor bazuar në shkollë.

Aktivitetet (shembuj):

1. Mundësimi i planifikimit të përbashkët financiar nga sektorë të ndryshëm për zbatimin e aktiviteteve të promocionit shëndetësor
2. Marrja e vendimeve të përbashkëta ndërmjet MSHMS dhe MARS për të kryer aktivitete të promocionit shëndetësor në arsimin e detyrueshëm në nivel kombëtar.

Objektivi specifik 3.3: Forcimi i kapacitetit të organizatave me bazë në komunitet, bizneseve, drejtuesve të komunitetit dhe shoqërisë civile për të hartuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar nismat e promocionit shëndetësor

Objektivi strategjik 4: *Fuqizimi i shërbimeve shëndetësore dhe forcimi i komunikimit të riskut si përgjigje ndaj emergjencave*

Objektivi specifik 4.1: Forcimi në nivel qendror dhe rajonal i sektorit të kujdesit shëndetësor për gatishmërinë, koordinimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i shërbimeve teknike kryesore të Sektorit të Kujdesit Shëndetësor përmes përdorimit të kompetencave, burimeve dhe ekspertizës së aktorëve kyç, për t'iu përgjigjur nevojave të popullatës në raste emergjente.

Objektivi specifik 4.3: Forcimi i Menaxhimit të Informacionit dhe kapacitetet e komunikimit të riskut për të siguruar gjatë emergjencës informacion në kohë reale dhe në të gjitha nivelet e menaxhimit të tij.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani Shqiptar i Veprimit për Promocionin Shëndetësor 2022-2030 do të monitorohet përmes një grupi treguesish bazë në vitin 2020 dhe objektivat për 2026 dhe 2030. Objektivat dhe treguesit janë përafruar me OZHQ-të në Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 dhe deklaratat e OBSH-së mbi promocionin e shëndetit, si dhe me Strategjinë e Re Kombëtare Shqiptare për Shëndetin 2021-2030; Planin e Veprimit të SJT 2021-2030; Planin e Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2022-2030 dhe strategjitë dhe angazhimet e tjera kombëtare ekzistuese.

Do të hartohet një udhëzues me instruksione që do të shpjegojë se si do të matet secili tregues. Të dhënat do të mblidhen nga institucionet kombëtare përgjegjëse për aktivitete të veçanta; nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare; vlerësimet e standardizuara, dhe studimet e politikave dhe programeve, si dhe burimeve të tjera. Vlerat fillestare dhe objektivat për treguesit janë përcaktuar për vitin 2020. Një rishikim afatmesëm i këtij Plani Veprimi do të përgatitet në 2026, dhe një raport përfundimtar do të përgatitet për Organet Drejtuese në vitin 2031.

ANEKS. OBJEKTIVAT SPECIFIKE, INDIKATORËT DHE AKTIVITETET

Kjo shtojcë ofron tekstin e plotë të "Planit të Veprimit për Promocionin Shëndetësor, Shqipëri 2022-2030", me disa modifikime të vogla.

Qëllimi është që t'i mundësojë lexuesit të identifikojë objektivat specifike që lidhen me ta (p.sh. aktivitetet shkollore të rëndësishme për mësuesit dhe prindërit, objektivat e qeverisjes për parlamentarët dhe administratorët, etj.).

Objektivi Strategjik 1

Rritja e vetëdijes së popullatës shqiptare për shëndetin dhe orientimi drejt një mënyre jetese të shëndetshme si dhe aksesit dhe përdorimit të duhur të shërbimeve shëndetësore.

Objektivi specifik 1.1: Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës rreth rëndësisë së shërbimeve të lidhura me identifikimin e hershëm të problemeve shëndetësore (*ekzaminimi mjekësor i popullatës 35-70 vjeç, shërbimi shëndetësor i nënës dhe fëmijës, shërbimet për të rinjtë dhe të rriturit, programet depistuese, etj.*).

Indikatorët:

- Përdorimi i shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë nga të paktën 70% e popullatës target (individët 35-70 vjeç).
- Të paktën 80% e popullatës target përdor në mënyrën e duhur shërbimet e monitorimit të shtatzënisë dhe mirërritjes së fëmijës.
- Të paktën 50% e të rinjve përdorin shërbimet shëndetësore miqësore për të rinjtë (shëndeti riprodhues dhe seksual, abuzimi me substancat, shëndeti mendor, etj.).

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave sensibilizuese për rëndësinë e kontrollit mjekësor falas.
2. Organizimi i fushatave sensibilizuese për rëndësinë e monitorimit të shtatzënisë dhe më pas zhvillimit dhe mirërritjes së foshnjave.
3. Organizimi i fushatave sensibilizuese për rëndësinë e shërbimeve shëndetësore për moshat e reja (shëndeti riprodhues dhe seksual, shëndeti mendor, abuzimi me substancat).

Objektivi specifik 1.2: Promovimi i një stili jete të shëndetshme për të gjithë popullatën shqiptare për të siguruar fëmijë, adultë dhe të moshuar më të shëndetshëm.

Indikatorët:

- 60% e të rinjve në shkolla kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me ushqyerjen e shëndetshme.
- Rritja me 20% e ushqyerjes me gji e fëmijëve 0-2 vjeç.
- Ulja me 30% e kequshqyerjes të fëmijët 0-5 vjeç.

- Ulja me 20% e mbipeshës te fëmijët e moshës shkollore dhe popullatës së përgjithshme.
- Ulja me të paktën 20% e anemisë te fëmijët e moshës shkollore dhe popullatës së përgjithshme.
- Rritja me 30% e nivelit të aktivitetit fizik ditor te fëmijët e moshës 11-15 vjeç.
- Ulja me 20% e jetës sedentare te popullata 35-70 vjeç për të gjitha grupmoshat.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e nismave që rrisin disponueshmërinë, aksesueshmërinë dhe përballueshmërinë e ushqimit të ushqyeshëm, veçanërisht në mesin e atyre grupeve më vulnerabël nga ushqimi i varfër.
2. Zhvillimi i programeve që rrisin njohuritë mbi ushqimet dhe ushqyerjen dhe aftësitë e prindërve, fëmijëve dhe grupeve të tjera më vulnerabël nga ushqimi i varfër.
3. Inkurajimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave organizative që lehtësojnë rritjen e aktivitetit fizik dhe zvogëlojnë sjelljen sedentare, veçanërisht në mjediset kryesore si shkollat dhe vendet e punës.
4. Organizimi i fushatave kombëtare mbi iniciativat për ndryshimin e sjelljes për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme për të gjitha grup-moshat.
5. Organizimi i fushatave publike edukuese që rrisin ndërgjegjësimin për përfitimet që ka aktiviteti fizik dhe motivojnë e mbështesin rritjen e aktivitetit fizik dhe zvogëlimin e sjelljes sedentare gjatë gjithë jetës.
6. Puna me qeveritë vendore për të zhvilluar plane lokale të shëndetit publik, përfshirë aktivitetet që mbështesin ushqyerjen më të shëndetshme dhe adresojnë inaktivitetin fizik dhe sjelljen sedentare.
7. Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të shëndetit për të adresuar gjendjen e ushqyerjes së popullatës, inaktivitetin fizik dhe sjelljen sedentare në programet, politikat dhe planet e tyre.
8. Forcimi i kapaciteteve në nivel rrethi i personelit pedagogjik dhe shëndetësor të shkollave mbi sjelljet e shëndetshme (ushqyerje e shëndetshme dhe aktiviteti fizik), si pjesë e paketës prej 12 modulesh të OBSH-së për shkollat.
9. Forcimi i sistemit të monitorimit të ushqyerjes së fëmijëve në Shqipëri
10. Monitorimi i obezitetit çdo 3 vjet te fëmijët e moshës 6-9.9 vjeç si pjesë e Studimit European të Mbikëqyrjes së Obezitetit në Fëmijëri (COSI).
11. Kryerja çdo 4 vjet e studimit mbi sjelljet e shëndetshme të fëmijëve 11, 13 dhe 15 vjeç (HBSC).
12. Zbatimi me faza në të gjithë vendin i “Iniciativës Europiane për Shkolla me Aktivitet Fizik dhe Ushqyerje të Shëndetshme” (HEPS).
13. Implementimi i Programit Health Academy për aktivitetin fizik dhe ushqyerjen për të rinjtë e moshës 12-18 vjeç.
14. Forcimi i kapaciteteve të stafit të maternitetit për fillimin e hershëm të ushqyerjes me gji (brenda 1 ore nga lindja).

15. Forcimi i kapaciteteve të personelit shëndetësor nga qendrat e konsultimit të fëmijëve për promovimin e ushqyerjes ekskluzive me gji.
16. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë nga KSHP për të përmirësuar kujdesin për ushqyerjen dhe zhvillimin e fëmijëve.
17. Promovimi i Iniciativës "Spitalet miqësore për foshnjat" me qëllim shtrirjen në të gjitha maternitetet në Shqipëri.
18. Përmirësimi i kurrikulave bazë dhe ekstrakurrikulare në sistemin shkollor parauniversitar mbi ushqyerjen e shëndetshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe institucionet e tjera të linjës.

Objektivi specifik 1.3: Reduktimi i sjelljeve të rrezikshme në mesin e popullatës shqiptare (pirja e duhanit, përdorimi i dëmshëm i alkoolit dhe droga të paligjshme)

Indikatorët:

- 85% e fëmijëve dhe e të rinjve të moshës shkollore kanë njohuri të mjaftueshme mbi rreziqet e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave.
- Ulja me 10% e duhanpirësve aktual në popullatën 15-64 vjeç.
- Ulja me 15% e duhanpirësve meshkuj në popullatën 15-64 vjeç.
- Ulja me 5% e duhanpirësve femra në popullatën 15-64 vjeç.
- Ulja e tendencë së fillimit të duhanpirjes te fëmijët e moshës shkollore 11-15 vjeç.
- Ulja me 50% e përdorimit të alkoolit te fëmijët e moshës 11-15 vjeç.
- Ulja me 30% e përdorimit të kanabisit në popullatën 15-64 vjeç.
- Ulja me 30% e përdoruesve të kanabisit dhe kokainës në popullatën 15-34 vjeç.
- Ulja me 50% e përdoruesve të drogave ilegale te fëmijët e moshës shkollore 11-15 vjeç.

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave kombëtare për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme në mesin e popullatës shqiptare, të fokusuara në pirjen e duhanit, përdorimin e dëmshëm të alkoolit dhe drogat e paligjshme: "Dita Botërore Pa Duhan"; "Fushata Botërore e Drogës".
2. Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e ligjit anitduhan, ligjit kundër konsumimit të alkoolit nga të miturit dhe ligjit kundër përdorimit të drogës.
3. Puna me qeveritë vendore për të zhvilluar plane lokale të shëndetit publik që përfshijnë masa për të adresuar kontrollin e duhanit.
4. Forcimi i kapaciteteve në nivel rrethi i personelit shëndetësor në shkolla mbi sjelljet e rrezikshme (pirja e duhanit, përdorimi i dëmshëm i alkoolit dhe droga të paligjshme) dhe pasojat e tyre në shëndet, si pjesë e paketës prej 12 modulesh të OBSH-së për shkollat.
5. Trajnim në nivel rrethi i personelit shëndetësor në KSHP "Ndërhyrjet për lënien e Duhanit dhe Alkoolit" sipas modulit të ofruar nga OBSH.

6. Kryerja e studimit mbi vlerësimin e duhanpirjes te të rinjtë në shkolla, në kuadër të “Iniciativës Globale të Studimit mbi Duhanpirjen” (GYTS).
7. Kryerja e studimit mbi sjelljet e rrezikshme te të rinjtë (YRBS).
8. Kryerja në mënyrë periodike e studimit mbi vlerësimin e përdorimit të drogave ilegale te të rinjtë në shkolla, në kuadër të Iniciativës Europiane të Studimit ESPAD.
9. Vlerësimi i nivelit të përdorimit të drogave ilegale në popullatën e përgjithshme, nëpërmjet kryerjes së studimit të GPS-së.

Objektivi specifik 1.4: Reduktimi i dhunës në popullatën shqiptare (të gjitha llojet e dhunës dhe për çdo grup-moshë).

Indikatorët:

- Ulja me 30% e rasteve të dhunës (fizike, emocionale dhe neglizhimit) tek fëmijët dhe të rinjtë e moshës shkollore.
- Ulja me 30% e rasteve të dhunës në familje (dhuna nga partneri intim, dhuna ndaj fëmijëve, dhuna ndaj të moshuarve) dhe grupeve të tjera të disavantazuara.

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave kombëtare mbi strategjitë e ndryshimit social dhe të sjelljeve për adresimin e dhunës ndaj grupeve më vulnerabël (fëmijët, gratë, të moshuarit).
2. Shkallëzimi i implementimit të programit të vizitave në shtëpi në nivel kombëtar në Shqipëri.
3. Hartimi i programeve të prindërimit pozitiv, bazuar në paketën INSPIRE (OBSh).
4. Trajnimi i përfaqësuesve të medias mbi mënyrën e raportimit të rasteve të dhunës në familje.
5. Hartimi i moduleve shkollore ekstrakurrikulare për njohjen e shenjave të abuzimit seksual të fëmijëve, në rrethin e tyre të besimit.
6. Forcimi i kapaciteteve kombëtare për parandalimin, identifikimin, trajtimin dhe referimin e fëmijëve të abuzuar.
7. Kryerja e studimit “Prevalenca e përvojave negative gjatë fëmijërisë”, te studentët shqiptarë (ACE).
8. Kryerja e një studimi mbi abuzimin e të moshuarve në Shqipëri.
9. Kryerja e një studimi mbi abuzimin nga partneri intim ndaj grave në Shqipëri.

Objektivi specifik 1.5: Parandalimi i lëndimeve dhe promovimi i komuniteteve më të sigurta.

Indikatorët:

- 60% e të rinjve të shkollave kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me faktorët e rrezikut dhe parandalimin e lëndimeve.
- Ulja me 30% e aksidenteve rrugore të shkaktuara si rezultat i dhënies së makinaës nën influencën e alkoolit.

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave kombëtare për parandalimin e aksidenteve rrugore në kuadër të Javës Botërore të Parandalimit të Aksidenteve Rrugore.
2. Organizimi i fushatave kombëtare në kuadër të Ditës Botërore të Ndihmës së Parë.
3. Hartimi i një plani veprimi multisektorial për parandalimin e aksidenteve rrugore.
4. Trajnimi në nivel rrethi i personelit shëndetësor në shkolla mbi parandalimin e aksidenteve rrugore, si pjesë e paketës prej 12 modulesh të OBSH-së për shkollat.
5. Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë për të adresuar parandalimin e dëmtimeve / lëndimeve në programet, politikat dhe planet e tyre.
6. Ngritja e sistemit të survejancës së aksidenteve rrugore në ISHP.
7. Puna me qeveritë vendore për zhvillimin e planeve lokale të shëndetit publik, përfshirë strategjitë për parandalimin e dëmtimeve/lëndimeve dhe promovimin e komuniteteve më të sigurta.

Objektivi specifik 1.6: Pëmirësimi i njohurive dhe praktikave mbi shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar në popullatën shqiptare.

Indikatorët:

- Ulja me 50% e fillimit të marrëdhënieve seksuale para moshës 16 vjeç.
- Rritja me 25% e përdorimit të kondomit te djemtë e moshës nën 16 vjeç.
- Rritja e përdorimit të kondomit te meshkujt e grup-moshës 15-49 vjeç nga 4% në 30%.
- Rritja me 50% e përdorimit të kondomit te femrat e moshës 15 vjeç.
- Rritja e përdorimit të metodave moderne të planifikimit familjar te femrat e moshës riprodhuese nga 4% në 15%.

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave kombëtare për ndërgjegjësimin e popullatës për përdorimin e metodave moderne kontraceptive dhe shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues.
2. Organizimi i fushatave kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimin të grave mbi rëndësinë që ka depistimi sistematik për kancerin e gjirit dhe të qafës së mitrës.
3. Trajnimi i specialistëve të edukimit dhe promocionit shëndetësor për mënyrën e komunikimit me komunitetin lidhur me çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.
4. Përmirësimi i kurrikulave shkollore rreth aspekteve të shëndetit seksual dhe riprodhues përfshirë dhe metodat moderne të planifikimit familjar.

Objektivi specifik 1.7 Promovimi i parandalimit të sëmundjeve ngjitëse

Indikatorët:

- Rritja me 10% në nivel kombëtar e numrit të aktiviteteve (dhe numrit të personave të përfshirë) të edukimit mbi higjienën në shkolla ose në komunitet
- Mbi 60% e fëmijëve kane njohuri të sakta mbi mënyren fekalo-orale të përhapjes së infeksioneve dhe rëndësinë e ujit dhe sanitetit në shëndetin komunitar.
- Shumica e personave kyç në komunitet janë të ndërgjegjshëm për mënyrat e kontrollit dhe monitorimit të ujit të pijshëm.

Aktivitetet:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës për rolin e higjienës personale dhe të komunitetit në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.
2. Zhvillimi i një plani komunikimi të një shpërthimit (outbreak).
3. Zhvillimi i një strategjie komunikimi për vaksinat ndaj COVID-19.
4. Rritja e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e antibiotikëve përmes fushatës së Javës Botërore të Ndërgjegjësimit për Antibiotikët.
5. Forcimi i kapaciteteve në nivel rrethi i personelit shëndetësor në shkolla mbi higjienën personale, si pjesë e paketës prej 12 modulesh të OBSH-së për shkollat.

Objektivi Strategjik 2

Fuqizimi i mjediseve mbështetëse dhe nxitja e ndërhyrjeve efikase për zbatimin e programeve të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor

Objektivi specifik 2.1: Zhvillimi i nismave të qëndrueshme kombëtare që promovojnë mjedise të shëndetshme me fokus popullatat në situata vulnerabël.

Indikatorët: Zhvillimi i dy ose më shumë politikave kombëtare të veçanta për mjedise të shëndetshme me fokus popullatat vulnerabël.

Aktivitetet:

1. Zhvillimi i udhëzimeve, kriterëve, mjeteve dhe modeleve të bazuara në evidenca për mjedise kryesore të shëndetshme.
2. Krijimi i rrjeteve dhe iniciativave të bazuara në mjedise të shëndetshme kombëtare, me theks të veçantë në institucionet (p.sh. shkollat dhe vendet e punës).
3. Ndërtimi i kapaciteteve dhe partneriteteve në nivel kombëtar dhe lokal për të aplikuar dhe dokumentuar efektivitetin e politikave ndër-sektorale që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e iniciativave për mjedise të shëndetshme.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e aksesit të popullatës në shkollat promovuese të shëndetit me qasjet e DSSH.

Indikatorët: Numri i rretheve që po zbatojnë politika ose strategji të bazuara në udhëzimet kombëtare për shkollat e shëndetshme.

Aktivitetet:

1. Zgjerimi i rrjeteve shkollore që promovojnë shëndet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar Planifikim dhe bashkim me rrjetin e shkollave që promovojnë shëndet (Shkollat për Shëndetin në Evropë, SHE).
2. Zhvillimi, miratimi dhe zbatimi i politikave për shkollat promovuese të shëndetit.
3. Forcimi i kapaciteteve të specialistëve të promocionit shëndetësor që punojnë në nivel qendror (ISHP) dhe atë lokal (trajnim afatshkurtër në fushën e promovimit të shëndetit me fokus ndërhyrjet në shkollë).
4. Forcimi i kapaciteteve për personelin shëndetësor të shkollave në çështjet e promocionit dhe edukimit shëndetësor.
5. Ngritja e kapaciteteve për mësuesit që punojnë me tema shëndetësore.
6. Ngritja e kapaciteteve për specialistët e sigurisë ushqimore në çështjet e promocionit dhe edukimit shëndetësor që lidhen me ushqimin e shëndetshëm dhe të sigurt të fëmijëve.
7. Ngritja e kapaciteteve të stafit të bashkive (nivel qendror dhe lokal) në lidhje me promocionin dhe edukimin shëndetësor në shkolla.
8. Rishikimi i kurrikulave shkollore të sistemit parauniversitar për përfshirjen e aspekteve shtesë shëndetësore që kanë të bëjnë me parandalimin e sëmundjeve dhe promocionin e shëndetit.

Objektivi specifik 2.3: Shndërrimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor të të gjitha niveleve në Shqipëri në mjedise që promovojnë shëndet.

Indikatorët:

- 50% e institucioneve të kujdesit shëndetësor (spitale) janë të përfshira në programet e edukimit dhe promocionit shëndetësor.
- 90% e pacientëve që kanë kryer kontrollin mjekësor bazë (35-70 vjeç) janë këshilluar nga profesionistët e shëndetit për stilin e jetesës.
- 20% e profesionistëve të shëndetit të përfshirë në programet e edukimit dhe promocionit shëndetësor kanë kryer vizita në shtëpi apo në komunitet.

Aktivitetet:

1. Përgatitja e një udhëzuesi dhe protokolli përkatës për shndërrimin e çdo institucioni të kujdesit shëndetësor, përfshi spitalet, në mjedise që promovojnë shëndet.
2. Ngritja e kapaciteteve të personave kyç në të gjitha nivelet e institucioneve shëndetësore për krijimin e mjediseve të favorshme për promovimin e shëndetit.
3. Kryerja e vizitave mbështetëse në të gjitha nivelet e institucioneve shëndetësore përfshirë edhe spitalet për të iniciuar zbatimin sistematik të standarteve për krijimin e mjediseve të favorshme për promovimin e shëndetit.

4. Ngritja e rrjetit kombëtar të institucioneve të kujdesit shëndetësor që zbatojnë promocionin e shëndetit në mjediset e tyre, caktimi i koordinatorëve për çdo institucion dhe organizimi i takimeve vjetore për shkëmbimin e eksperiencës dhe nxitjen e praktikave më të mira në këtë drejtim.

Objektivi specifik 2.4: Rritja e përdorimit të teknologjisë, veçanërisht e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e mjediseve që promovojnë shëndetin.

Indikatorët:

- 70% e të rinjve në shkolla kanë njohuri të mjaftueshme mbi programet e edukimit dhe promocionit shëndetësor.
- 80% e qendrave shëndetësore janë të pajisura me mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- 20% e qendrave të punës të punës kanë akses në programet inovative të promocionit shëndetësor.

Aktivitetet:

1. Organizimi i fushatave informuese dhe edukative mbi probleme të ndryshme shëndetësore me të rinjtë në shkolla.
2. Pajisja graduale e qendrave shëndetësore me mjete adekuate të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Objektivi specifik 2.5: Rritja e efektivitetit në punë e profesionistëve të rrjetit të edukimit dhe promocionit shëndetësor.

Indikatorët:

- Detyrat dhe aftësitë profesionale të profesionistëve të rrjetit në të gjitha nivelet janë të përcaktuara (ToR, kualifikimet) dhe 90% e tyre janë të vetëdijshëm për to.
- 90% e profesionistëve të rrjetit janë të trajnuar për aftësitë planifikuese, zbatuese, monitoruese, vlerësuese, mbikëqyrje mbështetëse, raportuese të aktiviteteve të EPSH-së.

Aktivitetet:

1. Trajnimi në nivel kombëtar i profesionistëve të shëndetit për zhvillimin e aftësive të duhura të punës në komunitet (angazhimi i mobilizuesve/liderëve/mediatorëve të shëndetit).
2. Rishikimi i paketës bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor lidhur me komponentin e EPSH-së.

3. Hartimi i termave konkretë të referencës (përshkrimi i punës) për specialistët e edukimit dhe promocionit shëndetësor (udhëzues i standardizuar për detyrat dhe aftësitë profesionale bazë).
4. Krijimi dhe zhvillimi i një kursi specializimi afat gjatë në Promocion Shëndetësor, në bashkëpunim me ISHP dhe UMT.
5. Ndërtimi dhe aplikimi sistematik i një kursi trajnimit të akredituar për punonjësit e edukimit dhe promocionit shëndetësor mbi aftësitë e kërkuara dhe detyrat specifike që ata duhet të kryejnë në proceset e planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit, mbështetjen e survejimit dhe raportimit të aktiviteteve të edukimit dhe promocionit shëndetësor.
6. Përmirësimi i infrastrukturës së kabineteve të promocionit shëndetësor në të gjitha NJVKSH-të me pajisjet e nevojshme për të realizuar aktivitete të promocionit shëndetësor.

Objektivi specifik 2.6: Forcimi i sistemeve për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për të përmirësuar dokumentimin dhe shkëmbimin e praktikave, mësimet të nxjerra dhe rezultateve që lidhen me nisma të bazuara në mjedise, me fokus barazinë e individëve.

Indikatorët: Prodhimi i progres raporteve vjetore kombëtare mbi promovimin e shëndetit në të paktën dy kategori të mjediseve të shëndetshme.

Aktivitetet:

1. Evente vjetore mbi promovimin e shëndetit në mjedise të ndryshme (shkolla, institucione shëndetësore, vende pune, etj.), Si: konferenca, panaire, fushata etj.
2. Forcimi në vend i sistemit të informacionit shëndetësor për të gjurmuar aktivitetet dhe rezultatet nga programet për mjedise të shëndetshme, duke mundësuar mbikëqyrje dhe ndjekje në vazhdimësi, dhe duke përfshirë, nëse është e mundur, të dhëna që përfshijnë variabla që lidhen me promocionin shëndetësor.

Objektivi Strategjik 3

Përmirësimi i qeverisjes dhe punës ndër-sektoriale për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien dhe adresimin e përcaktorëve socialë të shëndetit

Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi dhe/ose forcimi i strukturave dhe nismave të qeverisjes vendore për të përfshirë promocionin shëndetësor si një prioritet.

Indikatorët:

- Krijimi i një rrjeti të Qyteteve të Shëndetshme duke përfshirë të paktën katër bashki.
- Mbajta çdo vit në nivel lokal i takime mbi diskutimin e temave të ndryshme që lidhen me prioritetet e promocionit shëndetësor.

Aktivitetet:

1. Krijimi në nivel rajonal i institucioneve dhe organizatave të rrjeteve të shoqërisë civile me fokus tek fëmijët, për të koordinuar përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit të politikanëve për rëndësinë e promovimit të shëndetit në përgjithësi, dhe atë të fëmijëve të shkollës në veçanti.
2. Krijimi i një rrjeti kombëtar për Qytetet e Shëndetshme dhe bashkëpunimi me shoqatat rajonale dhe kombëtare të qyteteve dhe bashkive për të siguruar që shëndeti të përfshihet në axhendat e tyre.
3. Zhvillimi i një udhëzuesi për Qytetet e Shëndetshme dhe planifikimi për tu bërë pjesë e Rrjetit Evropian të Qyteteve të Shëndetshme të OBSH -së.

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i bashkëpunimit të sektorit shëndetësor me sektorët e tjerë publik që adresojnë DSSH në nivele të ndryshme qeveritare

Indikatorët:

- Themelimi i një komiteti ndërsektorial për promocionin shëndetësor bazuar në shkollë.
- Krijimi i një memorandum bashkëpunimi ndër-sektorial.
- Një marrëveshje midis MSHMS dhe MARS për aktivitetet e përbashkëta të promocionit shëndetësor.

Aktivitetet:

1. Themelimi i një komiteti ndër-sektorial për promovimin e shëndetit në shkolla.
2. Zhvillimi i informacioneve specifike/aktiviteteve të ndërgjegjësimit për grupet e ndryshme vendimmarrëse (autoritetet shëndetësore dhe arsimore, këshillat bashkiakë dhe komitetet përkatëse parlamentare)
3. Institucionalizimi i marrëdhënieve midis sektorëve të ndryshëm përmes një memorandum bashkëpunimi, i cili do të lehtësojë ndjeshëm bashkëpunimin mes tyre.
4. Mundësimi i planifikimit të përbashkët financiar nga sektorë të ndryshëm për zbatimin e aktiviteteve të promocionit shëndetësor
5. Marrja e vendimeve të përbashkëta ndërmjet MSHMS dhe MARS për të kryer aktivitete të promocionit shëndetësor në arsimin e detyrueshëm në nivel kombëtar.

Objektivi specifik 3.3: Forcimi i kapacitetit të organizatave me bazë në komunitet, bizneseve, drejtuesve të komunitetit dhe shoqërisë civile për të hartuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar nismat e PSH

Indikatorët:

- Kryerja e studimeve mbi eksplorimin e mjeteve më efektive për bashkëpunimin ndër-sektorial.

- Takime vjetore në formën e dialogut të politikave midis sektorit publik dhe sektorit privat që synojnë nxitjen e bashkëpunimit efektiv për promocionin shëndetësor.

Aktivitetet:

1. Përfshirja e OJQ-ve, shoqërisë civile, akademisë, mediave dhe komunitetit në tërësi në vendimmarrje dhe në zbatimin e të gjitha programeve të promocionit shëndetësor me fëmijët e shkollave.
2. Gjetja e mekanizmave dhe stimujve të përshtatshëm për të promovuar bashkëpunimin e qëndrueshëm midis sektorit publik dhe privat për të bashkëfinancuar programet e promocionit shëndetësor për fëmijët e shkollave.
3. Promovimi i kërkimit shkencor që fokusohet në qasjet multi-sektoriale për promocion shëndetësor.
4. Sigurimi i pjesëmarrjes së komunitetit me vendimmarrësit në krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave publike që ndikojnë në shëndet.
5. Forcimi i kapaciteteve të drejtuesve të komuniteteve për planifikimin, zbatimin, monitorimin e aktiviteteve të promocionit shëndetësor në nivel komuniteti.
6. Vlerësimi i programeve të bazuara në komunitet për të përcaktuar efektivitetin e tyre.

Objektivi Strategjik 4

Fuqizimi i shërbimeve shëndetësore dhe forcimi i komunikimit të riskut si përgjigje ndaj emergjencave

Objektivi specifik 4.1: Forcimi në nivel qendror dhe rajonal i sektorit të kujdesit shëndetësor për gatishmërinë, koordinimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave.

Indikatori: Krijimi i mekanizmave politik për forcimin dhe sigurimin e koordinimit ndërsektorial në raste emergjence.

Aktivitetet:

1. Rishikimi i kornizave ligjore dhe rregullatore përkatëse.
2. Integrimi i Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Operatorëve të Kujdesit Shëndetësor me qëllim zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, emergjencat dhe rritjen e mirëqenies së popullatës.
3. Përmirësimi dhe sigurimi i kujdesit parësor me cilësi të mirë mbështetur në funksionet kryesore të shëndetit publik.
4. Angazhimi dhe fuqizimi i njerëzve.
5. Forcimi dhe promovimi i veprimeve shumë sektoriale për të ndaluar pabarazitë.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i shërbimeve teknike kryesore të Sektorit të Kujdesit Shëndetësor përmes përdorimit të kompetencave, burimeve dhe ekspertizës së aktorëve kyç, për t'iu përgjigjur nevojave të popullatës në raste emergjente.

Indikatori: Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve thelbësore bazuar në planin operacional dhe udhëzimet kombëtare.

Aktivitetet:

1. Ngritja e kapaciteteve për të kuptuar se në emergjenca kujdesi i vazhdueshëm është vendimtar.
2. Promovimi i përdorimit të njohurive më të fundit shkencore në lidhje me menaxhimin e rrezikut emergjent.
3. Orientimi i sistemeve shëndetësore drejt kujdesit shëndetësor parësor si dhe forcimi i menaxhimit të rrezikut emergjent.
4. Trajnimi i stafit të ri për të forcuar kapacitetet koordinuese dhe komunikuese për zbulimin, parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve të shëndetit publik.
5. Sigurimi që do të ketë burime njerëzore të mjaftueshme të trajnuara për t'iu përgjigjur një emergjence të caktuar.

Objektivi specifik 4.3: Forcimi i Menaxhimit të Informacionit dhe kapacitetet e komunikimit të riskut për të siguruar gjatë emergjencës informacion në kohë reale dhe në të gjitha nivelet e menaxhimit të tij.

Indikatori: Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzuesve për komunikimin e riskut si dhe hartëzimi i punonjësve shëndetësorë të trajnuar për këtë qëllim.

Aktivitetet:

1. Trajnime mbi komunikimin me popullatën duhet të jenë strategjike dhe sistematike, si dhe të kryhen rregullisht.
2. Përcaktimi, trajnimi, dhe mbështetja e zëdhënësve të besueshëm dhe efektivë të cilët do të jenë fytyra e agjencive kyçe dhe e task forcës/grupit të punës, dhe do të japin përditësime të rregullta për të siguruar komunikimin transparent dhe për të fituar besimin e publikut.
3. Përmirësimi i komunikimit të riskut në vend dhe ngritja e një grupi kombëtar ekspertësh të komunikimit të riskut në emergjenca.
4. Zhvillimi i mjeteve, udhëzuesve dhe burimeve. Zhvillimi i mjeteve dhe udhëzuesve për nevojat e komunikimit të riskut, përfshirë monitorimin dhe vlerësimin.
5. Sigurimi i kapaciteteve të qëndrueshme dhe të duhura për të parashikuar dhe luftuar informacionet e rreme, thashethemet, dhe keqinformimin gjatë emergjencave në shëndetin publik.
6. Krijimi i rrjeteve kombëtare dhe nismave me përfshirjen e komunitetit dhe ndërtimi sëbashku i besimit në popullatë.
7. Përmirësimi i edukimit të popullatës nëpërmjet mass medias (televizioni, radio dhe gazeta) edukatorët e shëndetit si dhe në bashkëpunim me sektorët e tjerë.